


AKT THEMELUES

KONTRATE

I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE "PASHKASHASH" sh.p.k.



Te nenshkruarit:

- 1- Arta Dumi, 1 biri I Hajdarit, datl. 1967, lindur e banues ne Tirane, Rr. "Ali Visha", Nr.30.
- 2- Agron Jaupllari, 1 biri I Irfanit, datl. 1958, lindur e banues ne Tirane, Bul."Zogu 1", Pall. prane Fakultetit Shkencave, Ap.Nr.2.

Mbeshtetur ne nenin 251, shkronja "c", te Ligjt Nr.7512 date 10.08.1991" Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimitarise private dhe privatizimit", krijojme shoqerine tregetare private me perjegjesi te kufizuar te quajtur "**PASHKASHASH**" dhe lidhim kontraten si vijon:

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur "**PASHKASHASH**" sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimitarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

VEND-QENDRIMI I SHOQERISE

NENI 2

Vend-qendrimi I shoqerise tregetare private "**PASHKASHASH**" sh.p.k. do te jetë ne Tirane, Bul."Zogu 1", Pall. prane Fakultetit Shkencave, Zyra Nr.1.

Shoqeria do te hap dhe vend-qendrime te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente dhe jashte vendit.

OBJEKTI I VEPRIMITARISE

NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e: Studime, projekte, shfrytezim guroresh, hapje tunelesh, prodhimin e materialeve inerte nga impjante, copetim, perpunim e prodhim I materialeve te ndertimit, prodhime betoni, parafabrikate, dhe konstruksion per ndertim pallatesh, objekte industriale, ujesjellesa e kahade, dhe ndertim rrugesh. Ruajtje, transport dhe perdonim te lendeve plasese ne Shqiperi dhe jashte saj. Tregetimit me shumice e pakice dhe import eksport te mallrave te ndyshme ushqimore, industriale, pije, konfeksione, fruta-perime, materiale ndertimi e nenprodukteve te tyre, elektro-shtepiake, prodhime bujqesore e blegtorale, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike dhe elektronike, hidro-sanitare, hidraulike, kinkaleri, kanceleri zyre e shkolle, pjese kembimi per auto, bateri, goma. Tregetim bimesh medicinale, eterovajore, pleherash e prodhimesh kimike, prodhimesh kozmetike dhe estetike. Ndertimit, zbatimit, punime dheu, sistemime, taracime terenesh. Ndertime civile dhe ekonomike, ndertime vepra arti, punime mbrojtje dhe sistemime hidraulike. Rikonstruksione godinash civile ekonomike, kryerje e situacioneve, preventivave dhe zbatim objektesh te ndryshme ndertimi. Transport mallrash e udhetaresh brenda dhe jashte vendit.

NENI 4

Per kryerjen e veprimitarise se saj shoqeria do te hape njesi prodhimi, perpuniimi, shembimi tregetimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali I shoqerise tregetare private "PASHKASHASH" sh.p.k do jete 100.000 leke, dhe do te perbehet nga kuotat e ortakeve themelues te shoqerise, si vijon:

Artan Dumi.....50%

Agron Jaupllari.....50%

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuotat e pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emeruara dhe te pa ndashme. Kapitali eshte teresish I shlyeshem dhe I nenshkrueshem.

NENI 7

Ortaket duhet te bejne perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruajne sekretin e saj dhe te mos demtojne interesat e personave te tjere dhe te shoqerise

DREJTIMITI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori I saj I jashtem I caktuar nga ortaket themelues te shoqerise z. **Xhevahir Dermishi**. Administratori ka te drejte te administroje pasurine e shoqerise dhe te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise. Ortaket e shoqerise kane te drejta e detryrime te barabarta ndaj shoqerise e ligjeve.

NENI 9

Te ardhurat neto te shoqerise I takojne ortakeve themelues te shoqerise, ne proporcione me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar.

NENI 10

Ortaket emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ata kane te drejte te caktojne financier, likuidator per problemet e shoqerise, si dhe te pajtojne persona te tjere si ortatake Financieri nxjerr rregullisht treguesit finanziare te tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

NENI 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme, me tekstin per rrethin e saj.

NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plete te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Mbi krijuimin e shoqerive tregetare".

NENI 14

Ky akt themelimi (kontrate) do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kopetente

NENI 15

Akti i themelimit,(kontrata) u perpilua ne disa kopje per t'u shperndare organeve kopetente dhe nje kopje do te mbetet dokumentacioni baze te shoqerise tregetare private "**PASHKASHASH**" sh.p.k

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES I SHOQERISE "PASHKASHASH" sh.p.k

Artan DUMI

Agron JAUPLLARI

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "PASHKASHASH"

Ne baze te Ligjit 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private, dhe privatizimit" dhe te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", me vullnetin tone te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit Themelues (kontrates) ortaket:

- 1- Artan Dumi, i biri I Hajdarit, datl.1967, lindur e banues ne Tirane, Rr."Ali Visha", Nr.30.
- 2- Agron Jaupllari, i biri I Irfanit, datl.1958, lindur e banues ne Tirane, Bul."Zogu 1", Pall. prane Fakultetit Shkencave, Ap.Nr.2.

Hartojne statutin e shoqerise si me poshte:

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

Shoqeria emertohet "PASHKASHASH" sh.p.k.

NENI 2

Selia e shoqerise tregetare private "PASHKASHASH" sh.p.k. do te jete ne Tirane, Bul."Zogu 1", Pall. prane Fakultetit Shkencave, Zyra .Nr.1. :

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregetar, prane Gjykaes se rrethit Tirane.

NENI 4

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e: Studime, projekte, shfrytezim guroresh, hapje tunelesh, prodhimin e materialeve inerte nga impjante, copetim, perpunim e prodhim i materialeve te ndertimit, prodhime betoni, parafabrikate, dhe konstruksion per ndertim pallatesh, objekte industriale, ujesjellesa e kanale, dhe ndertim rrugesh. Ruajtje, transport dhe perdorim te lendeve plasese ne Shqiperi dhe jashte saj. Tregetimit me shumice e pakice dhe import eksport te mallrave te ndyshme ushqimore, industriale, pije, konfeksione, fruta-perime, materiale ndertimi e nenprodukteve te tyre, elektro-shtepiake, prodhime bujqesore e blegtorale, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike dhe elektronike, hidro-sanitare, hidraulike, kinkaleri, kanceleri zyre e shkolle, pjese kembimi per auto, bateri, goma. Tregetim bimesh medicinale, eterovajore, pleherash e prodhimesh kimike, prodhimesh kozmetike dhe estetike. Ndertimit, zbatimit, punime dheu, sistemime, taracime terenesh. Ndertime civile dhe ekonomike, ndertime vepra arti, punime mbrojtje dhe sistemime hidraulike. Rikonstruksione godinash civile ekonomike, kryerje e situacioneve, preventivave dhe zbatim objektesh te ndryshme ndertimi. Transport mallrash e udhetaresh brenda dhe jashte vendit.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali i shoqerise tregetare private "PASHKASHASH" sh.p.k. do jete 100.000 leke, dhe do te perbehet nga kuotat e ortakeve themelues te shoqerise.

Kuotat e ortakeve te shoqerise ne kapitalin fillesttar jane ne proporcione si vijon:

Artan Dumi.....	50%
Agron Jaupllari.....	50%

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuotat e pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emeruara dhe te pa ndashme. Kapitali eshte teresist I shlyeshem dhe I nenshkrueshem. Çdo kuote I takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Ortaku qe ka ndermend te shesi kuotat e tij, teresist apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te shqerise. Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejta ortaku duhet ta ushtroje brenda 30 diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastim i mos-ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortaku qe do te shese kuaotat duhet te njoftoje emrin e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te ofruara ortakut tjeter te shoqerise.

NENI 7

Kapitali I shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te luajteshme e ose te paluajteshme etj te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 8

Kuotat e kapitalit fillestar jane dredhur nga ortaket themelues ne Banke, ne llogarine bankare te shoqerise, si edhe te regjistruara ne librin e llogarise te shoqerise.

NENI 9

Heqja dore e ortakut nga bashkepunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po keshtu ai fiton dhe te'drejtat qe jane krijuar para largimit te tij.

NENI 10

Fitimet qe realizohen gjate veprimitarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve, ne proporcione perqindjen e kapitalit te investuar, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali I investuar nga ortaket nuk mund te kaloje kuotat e percaktuara ne kapitalin fillestar. Rritja e kapitalit nga ortaket do te behet vetem me vendim unanim te Asamblese se ortakeve.

NENI 11

Shoqeria tregetare “**PASHKASHASH**” sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria tregetare “**PASHKASHASH**” sh.p.k. gezon te drejta sikunder çdo person tjeter juridik, shqiptar ose I huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 12

Shoqeria tregetare “**PASHKASHASH**” vepron ne regjin e prones private dhe merr persiper te drejtat e detyrimet vetem brenda kusirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues te shoqerise mbartin rrezikun e veprimitarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqeria nuk perfgjigjet per detyrimet qe ortaket kane patur para se ajo te krijohet.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 13

Organet drejtuese te shoqerise jane:
Asamblea e ortakeve.
Administratoret.
Komisioni i revisionimit.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese do te rregullohet ne statut. Asamblea e shoqerise perbehet nga 2 ortaket themelues.

Themeluesit e shoqerise e qeverisin ate duke u mbeshtetur ne te drejten e tyre te prones private te investuar ne kete shoqeri.

Vendimet qe merr Asambleja jane te detyrueshme per ortaket e shoqerise. Asambleja thirret sa here e shohin te arsyeshme ortaket themelues te shoqerise, por detyrimisht ne Dhjetor per te miratuar programin e veprimtarise per vitin e ardheshem dhe ne Mars per te miratuar bilancin kontabel te viti te meparshem.

NENI 14

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj I jashtem caktuar nga ortaket themelues te shoqerise, z. Xhevaliir Dermishi.

NENI 15

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme kur te jene pranuar unanimisht nga te gjithe ortaket themelues te shoqerise.

NENI 16

Hyjne brenda detyrave dhe kopetencave te asamblese se ortakeve si me poshte:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe bilancit e llogarise vjetore.
3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kopetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i tarifave per sherbimet qe kryen shoqeria.
6. Pranimet ne pune dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i formes se vules dalluese te shoqerise.

Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te Shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.

NENI 17

Administratori jo ortak pervec detyrave qe I caktojne ortaket e shoqerise ka edhe keto detyra e te tjera:

1. Te mire-administroje pasurine e shoqerise
2. Te beje marrveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kopetencave te caktuara nga ortaku themelues.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshime te shoqerise.
4. Te per gjigjet per demet qe I sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te marrveshjes se bere me ortakun themelues.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithçka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.
7. Te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

NENI 18

Shoqeria ka te dreje:

1. Te krye veprimitari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimitarise.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga Bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe I njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punetore te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

NENI 19

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur. Te jape garanci per sherbimet qe kryen shoqeria.

2. Te siguroje punonjesit e saj.

Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo. Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimitarine e saj.

MARRDHENJET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

NENI 20

E gjithe veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimitarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

NENI 21

Ne seline e shoqerise mbahet dokumantacioni finanziar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

NENI 22

Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

NENI 23

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

NENI 24

Nga fitimet e realizuara gjate vitit finanziar, shoqeria, pasi ben zbritjen e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5% te fitimit, me te cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", derisa ky fond te arrije masen 10% te kapitalit themeltar.

NENI 25

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondevet te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, imbesin ne perdonim ortakeve te shoqerise.

Fitimi I realizuar nga shoqeria do te ndahet ne mes te ortakeve te saj ne perputhje me kapitalet e investuara por pa kaluar perqindjet e percaktuara ne kapitalin fillestare. Ndarja e dividenteve behet sipas menyes dhe ne afatet qe vendos asambleja e shoqerise.

Konvertimi I parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e shtetit Shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi I saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

DISPOZITA TE VECANTA

NENI 26

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

SHNDERRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

NENI 27

Shnderrimi I shoqerise "**PASHKASHASH**" sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te asamblese se ortakeve.

NENI 28

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne cdo kohe dhe per çfar do shkaku si :

- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese te ortakeve

Ne keto raste, pronari I shqerise vendos mbi menyen e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke ju percaktuar dhe detyrat

Administratori dhe likuidatori jane perjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise perderi sa ajo t'u dorezohet personave perkates fizike e juridike, duke u likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria. Ne rast se fondet disponibel, rezultojene te pa mjaftueshme, per shlyerjen e detyimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe I takojne atij

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 29

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaku themelues, si edhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne menyen dhe proceduren me te cilien nxirret vete statuti.

NENI 30

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje imbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private "**PASHKASHASH**" sh.p.k.

ORTAKET THEMELUES I SHQERISE “PASHKASHASH” sh.p.k.

Artan DUMI

Agron JAUPLLARI